



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, INVESTIMEVE DHE  
INFRASTRUKTURËS

Nr. 12373 Prot

Shkodër, më 06.09.2023

**DËRGIM PROJEKT - VENDIM DHE RELACION**

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

**Të nderuar këshilltarë !**

Bashkangjitur ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shpjegues "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri"

Duke ju uruar punë të mbarë !

Me respekt

**KRYETAR**

**BENET BECI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, INVESTIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS**

Nr. \_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z. KOL ROGA, ZNJ. SOFI DEMAJ, ZJ. MARIJE DEMAJ, Z. YLLI DEMAJ, ZJ. DILE DEMAJ, Z.KOL FUSHA, Z.ARBEN MUÇO, Z.TOM SHLLAKU, Z.ERMAL HAXHIJA, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI”.**

Këshilli Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës \_\_\_\_ 2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar; Ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”; Ligjin nr.68/2017 ‘Për financat vendore’ i ndryshuar; VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“; VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar; VKB Nr 71 datë 27.12.2022 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës”, te ndryshuar ; VKB nr. 14, datë 20.07.2023 “Për shtesë në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me “Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë dhe në Relacionin nr \_\_\_\_ prot, date \_\_\_\_ e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

## VENDOSI :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **z. Kol Roga** (2 anëtarë familje), në vlerën prej 40 000 (dyzet mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **z. Kol Roga** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 749 350 (shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e tre qind e pesëdhjetë) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 476 960 (katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **z. Kol Roga**.
3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **znj. Sofi Demaj** (1 anëtar familje), në vlerën prej 20 000 (njëzet mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **znj. Sofi Demaj** në vlerën e dëmit në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 92 300 (nëntëdhjetë e dy mijë e treqind lekë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **znj. Sofi Demaj**.
5. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **zj. Marije Demaj** (1 anëtar familje), në vlerën prej 20 000 (njëzet mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.
6. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **zj. Marije Demaj** në vlerën e dëmit në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 92 300 (nëntëdhjetë e dy mijë e treqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **zj. Marije Demaj**.
7. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **zj. Dile Demaj** (2 anëtarë familje), në vlerën prej 40 000 (dyzet mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.
8. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **zj. Dile Demaj** në vlerën e dëmit në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 131 700 (njëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **zj. Dile Demaj**.


9. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së z. **Ylli Demaj** (4 anëtarë familje), në vlerën prej 80 000 ( tetëdhjetë mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
10. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 278 300 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër. për familjen e z. **Ylli Demaj**, dhe në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 954 517 (nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë për familjen e **znj. Sofi Demaj, Marije Demaj, z. Ylli Demaj dhe Zj. Dile Demaj** (sipas Prokurës së posaçme me nr. Repertori: 1623 dhe nr. Koleksioni: 758 mbajtur në Shkodër më 29.08.2023).
11. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së z. **Kol Fusha** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 ( njëqind mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
12. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e . z. **Kol Fusha** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 228 079 (dyqind e njëzet e tetë mijë e shtatëdhjetë e nëntë) lekë dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 48 060 (dyzet e tetë mijë e gjashtëdhjetë ) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z.**Kol Fusha**.
13. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së z. **Arben Muço** (4 anëtarë familje), në vlerën prej 80 000 (tetëdhjetë mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
14. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së z. **Ton Shllaku** (3 anëtarë familje), në vlerën prej 60 000 ( gjashtëdhjetë mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
15. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e . z. **Ton Shllaku** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 1 692 161 ( një milion e gjashtëqind e nëntë dhjetë e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 614 560 ( gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë ) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Ton Shllaku**.
16. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së z. **Ermal Haxhija** (4 anëtarë familje), në vlerën prej 80 000 (tetëdhjetë mijë ) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.

17. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin P03280 “ Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2023 të miratuar me VKB Nr 71 datë 27.12.2022 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës” te ndryshuar , në programin P03280, Q1 O1 A2 “ Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 520 000 ( pesëqind e njëzet mijë ) lekë.
18. Për familjen e **Z. KOL ROGA, ZNJ. SOFI DEMAJ, ZJ. MARIJE DEMAJ, Z. YLLI DEMAJ, ZJ. DILE DEMAJ , Z. KOL FUSHA, Z. TON SHLLAKU**, kompensimi i dëmëve materiale ndërtimore sipas preventivave dhe në orendi e pajisje sipas vlerësimit do të bëhet në zbatim të Ligjit 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile “ pika 3.1/a nga fondet e kushtëzuara të akorduara nga Buxheti i Shtetit për vitin 2023 për Bashkinë Shkodër dhe VKB nr. 14, datë 20.07.2023, sipas Relacionit bashkëngjitur, në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën **1 812 053,5 (një million e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e tre presje pesë) lekë** dhe në masen 50% të vlerës së orendive në shumën **867 090 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë) lekë** .
19. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme në shumës prej 520 000 ( pesëqind e njëzet mijë ) lekë nga Buxheti i Bashkisë te miratuar “Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 te ndryshuar , aktiviteti **P03280.Q1.O1.A2** Përballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie.
20. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
21. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



**KRYETAR**  
**Benet BECI**


- Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës.

Alfred Luleta  


- Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor

Arben Hexo  


- Drejtoria e Financës

Blelta Myrta  


- Drejtoria Juridike

Harjeta Fushkha  




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E SHIËRBIMEVE PUBLIKE, INVESTIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS

## RELACION

### KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

#### Të nderuar këshilltarë !

Në vijim të procedurave për shkak të rënies së zjarrit në banesën e shtetasve : **z. Kol Roga**, banor i fshatit Bleran, Nj. Administrative Rrethina dëmtuar nga zjarri i rënë më datë 29.04.2023; **zj. Sofi Demaj**, **zj. Marije Demaj**, **z. Ylli Demaj**, **Zj. Dile Demaj**, banorë të fshatit Bruçaj të Nj. Administrative Pult , dëmtuar nga zjarri i rënë më datë 14.05.2023, **z. Kol Fusha** banor i Rr. Kamilo Libardi, L. nr. 5 dëmtuar nga zjarri i rënë më datë 17.12.2022, **z. Arben Muço** për banesën e marrë me qera sipas kontratës së qerasë me nr. Repertori: 91, Nr. Koleksioni : 65 mbajtur në Shkodër më 16.01.2023, dhe Deklaratës Noteriale me nr. Repertori: 2050 dhe Nr. Koleksioni: 1353 , mbajtur në Shkodër më 31.07.2023, e cila ndodhet në Rr. Koplিকেj, L. nr. 4, dëmtuar nga zjarri rënë më datë 14.06.2023, **z. Ton Shllaku** banor i fshatit Darragjat, Nj. Administrative Dajç dëmtuar nga zjarri i rënë më datë 01.08.2023, **z. Ermal Haxhija** për banesën e marrë me qera (pa kontratë qeraje), sipas Deklaratës Noteriale me nr. Repertori: 2999 dhe Nr. Koleksioni: 1964, mbajtur në Shkodër më 02.08.2023, e cila ndodhet në Bulevardin Zogu I, L. nr. 4, për zjarrin e rënë më datë 30.06.2023, bazuar në Ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, V.K.M. nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.”,

Ju paraqesim këtë propozim për dhënie të ndihmës së menjëhershme financiare si më poshtë:

Nr	Emri i kryefamiljarit	Numri i personave sipas certifikatës familjare	Koha kur është djegur ose demtuar banesa	Data e paraqitjes së kërkesës	Ndihma financiare e propozuar
1	Kol Roga	2	29.04.2023	05.05.2023	40 000

2	Sofi Demaj	1	14.05.2023	12.06.2023	20 000
3	Marije Demaj	1	14.05.2023	13.06.2023	20 000
4	Ylli Demaj	4	14.05.2023	13.06.2023	80 000
5	Dile Demaj	2	14.05.2023	13.06.2023	40 000
6	Kol Fusha	5	17.12.2022	19.07.2023	100 000
7	Arben Muço	4	14.06.2023	31.07.2023	80 000
8	Ton Shllaku	3	01.08.2023	02.08.2023	60 000
9	Ermal Haxhija	4	30.06.2023	03.08.2023	80 000
	<b>Shuma Totale</b>				<b>520 000</b>

Komisioni i vlerësimit të dëmeve ka bërë preventivat ndërtimore , vlerën e orendive e pajisjeve si pasojë e fatkeqësisë sipas VKM- së Nr. 329 date 16.05.2012. Kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore sipas preventivave si dhe në orendi e pajisje sipas vlerësimit do të bëhet në zbatim të Ligjit 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ neni 41 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile “ pika 3.1/a nga fondet e kushtëzuara të akorduara nga Buxheti i Shtetit për vitin 2023 për Bashkinë Shkodër, VKB nr. 14, datë 20.07.2023 “për shtesë në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me “Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 27.12.2022 “për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër”

Tabela e përfitimit sipas dëmeve ndërtimore dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake është:

Nr	Emri familjes	Vlera ndërtimore 1	Vlera e orendive 2	Vlera ndërtimore dhe e orendive 1+2	50 % Vlera ndërtimore 4	50 % Vlera e orendive 5	50 % Vlera ndërtimore dhe e orendive 4+5	Humbja e jetës 6	Dëmshpërblim për humbje jete 7
1	Kol Roga	749 350	476 960	1 226 310	374 675	238 480	613 155	-	-
2	Sofi Demaj		92 300	92 300		46 150	46 150	-	-
3	Marije Demaj		92 300	92 300		46 150	46 150	-	-



4	Ylli Demaj	954 517	278 300	1 232 817	477 258,5	139 150	616 408,5		
5	Dile Demaj		131 700	131 700		65 850	65 850		
6	Kol Fusha	228 079	48 060	276 139	114 039,5	24 030	138 069,5		
7	Ton Shllaku	1 692 161	614 560	2 306 721	846 080,5	307 280	1 153 360,5		
	Shuma përfundimtare	3 624 107	1 734 180	5 358 287	1 812 053,5	867 090	2 679 143,5		

Vlerat e dëmeve ndërtimore për familjen e znj. Sofi Demaj, Znj. Marije Demaj, Znj. Dile Demaj dhe Z. Ylli Demaj sipas Preventivit të hartuar i kalon sipas Prokurës së posaçme me nr. Repertori: 1623 dhe nr. Koleksioni: 758 mbajtur në Shkodër më 29.08.2023 Z. Ylli Demaj. Për rastet e dëmeve ndërtimore dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake për familjet e Z. Arben Muço dhe Z. Ermal Haxhija do të paraqiten në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Bashkiak, pasi do të bëhet ndarja e pjesëve takuese të dëmeve ndërtimore dhe dëmeve në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake pas dakortësisë ndërmjet qeramarrësit dhe qeradhënësit.

**KRYETAR**

**BENET BECI**

